



Në bazë të nenit 103 dhe 149 të Ligjit për arsim sipëror të RMV-së (82/18), Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e ligjit për arsim të lartë gjatë situatës së jashtëzakonshme (76/2020 dhe 116/20), Statutit të Universitetit të Tetovës, Rregullores për studimet e ciklit të parë, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për numrin e studentëve të cilët regjistrohen në institucionet e arsimit të lartë në vitin e parë të studimeve në vitin akademik 2020/21 nr. 44-4740/1 të datës 05.06.2020 (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.162, 16 qershor 2020), Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për kuota plotësuese për regjistrimin e studentëve të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në institucionet e arsimit të lartë në vitin e parë të studimeve të vitit akademik 2020/21 nr. 44-4900/1 dhe Vendimit të Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës nr. 02-998/1, Universiteti i Tetovës shpall:

## KONKURS

### për regjistrimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve në programet studimore të Universitetit të Tetovës në vitin akademik 2020/21

I. **Numri i studentëve:** në fakultetet e Universitetit të Tetovës, në vitin e parë të studimeve të ciklit I-rë në vitin akademik 2020/21, numri i studentëve që do të mund të regjistrohen është si në vijim:

FAKULTETI			Shuma e pagesës për vit (Euro)	Shuma e pagesës për vit (Euro)	Shuma e pagesës për vit (Euro)	Gjithsej vende të lira
Programi studimor	Kohëzgjatja e studimeve	Kuotë shtetërore	Koofinancim	Korrespondencë		
Drejtimi	ECTS (semestra)					
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE</b>		<b>265</b>	<b>200</b>	<b>180</b>	<b>400</b>	<b>455</b>
<b>Biologji</b>	240 (8)	<b>40</b>	200	<b>30</b>	400	<b>70</b>
Drejtimi arsimor						
Biokimi						
<b>Fizikë</b>	240 (8)	<b>15</b>	200	<b>5</b>	400	<b>20</b>
Drejtimi arsimor						
Profesional						
<b>Kimi-Fizikë</b>	240 (8)	<b>25</b>	200	<b>20</b>	400	<b>45</b>
<b>Kimi</b>	240 (8)	<b>15</b>	200	<b>10</b>	400	<b>25</b>
Arsimor						
Profesional						
Biokimi analitike						
<b>Matematikë drejtimi arsimor</b>	240 (8)	<b>35</b>	200	<b>25</b>	400	<b>60</b>
<b>Informatikë</b>	240 (8)	<b>50</b>	200	<b>40</b>	400	<b>90</b>
Arsimor						
Profesional						
Telekomunikime dhe teknologjitë kompjuterike						
<b>Informatika në biznes</b>	240 (8)	<b>20</b>	200	<b>10</b>	400	<b>30</b>
<b>Informatika në gjuhën angleze</b>	240 (8)	<b>10</b>	200	<b>10</b>	400	<b>20</b>
<b>Gjeografi</b>	240 (8)	<b>20</b>	200	<b>10</b>	400	<b>40</b>
Arsimor						
Profesional						
<b>Matematika financiare</b>	240 (8)	<b>15</b>	200	<b>10</b>	400	<b>25</b>
<b>Ekologji</b>	240 (8)	<b>20</b>	200	<b>10</b>	400	<b>30</b>
<b>FAKULTETI FILOZOFIK</b>	ECTS (S)	<b>115</b>	<b>200</b>	<b>65</b>	<b>400</b>	<b>220</b>
<b>Filozofi</b>	240 (8)	<b>20</b>	200	<b>10</b>	400	<b>40</b>
Arsimor						
<b>Sociologji</b>	240 (8)	<b>20</b>	200	<b>10</b>	400	<b>40</b>
Arsimor						
<b>Histori</b>	240 (8)	<b>20</b>	200	<b>10</b>	400	<b>40</b>



Arsimor								
Profesional								
<b>Psikologji</b>	240 (8)	<b>35</b>	200	<b>25</b>	400			<b>60</b>
Profesional								
<b>Filologji orientale</b>	240 (8)	<b>20</b>	200	<b>10</b>	400	<b>10</b>	400	<b>40</b>
Gjuhë dhe letërsi Turke								
Gjuhë dhe letërsi Arabe								
<b>FAKULTETI PEDAGOGJIK</b>	<b>ECTS (S)</b>	<b>80</b>	<b>200</b>	<b>75</b>	<b>400</b>	<b>25</b>	<b>400</b>	<b>180</b>
<b>Mësim klasor</b>	240 (8)	<b>25</b>	200	<b>20</b>	400	<b>10</b>	400	<b>55</b>
<b>Drejtimi parashkollor</b>	240 (8)	<b>15</b>	200	<b>15</b>	400	<b>10</b>	400	<b>40</b>
<b>Pedagogji- drejtimi profesional</b>	240 (8)	<b>15</b>	200	<b>15</b>	400	<b>5</b>	400	<b>35</b>
<b>Edukim special dhe rehabilitim</b>	240 (8)	<b>25</b>	200	<b>25</b>	400			<b>50</b>
<b>FAKULTETI FILOLOGJIK</b>	<b>ECTS (S)</b>	<b>140</b>	<b>200</b>	<b>100</b>	<b>400</b>	<b>50</b>	<b>400</b>	<b>290</b>
<b>Gjuhë dhe letërsi shqipe</b>	240 (8)	<b>20</b>	200	<b>20</b>	400	<b>10</b>	400	<b>50</b>
Arsimor								
<b>Gjuhë dhe letërsi angleze</b>	240 (8)	<b>40</b>	200	<b>30</b>	400	<b>10</b>	400	<b>80</b>
Arsimor								
<b>Gjuhë dhe letërsi maqedonase</b>	240 (8)	<b>20</b>	200	<b>10</b>	400	<b>10</b>	400	<b>40</b>
Arsimor								
<b>Gjuhë dhe letërsi gjermane</b>	240 (8)	<b>40</b>	200	<b>30</b>	400	<b>10</b>	400	<b>80</b>
Arsimor								
<b>Gjuhë dhe letërsi italiane</b>	240 (8)	<b>10</b>	200	<b>5</b>	400	<b>5</b>	400	<b>20</b>
Arsimor								
<b>Gjuhë dhe letërsi frënge</b>	240 (8)	<b>10</b>	200	<b>5</b>	400	<b>5</b>	400	<b>20</b>
Arsimor								
<b>FAKULTETI I ARTEVE</b>	<b>ECTS (S)</b>	<b>65</b>	<b>200</b>	<b>50</b>	<b>400</b>			<b>115</b>
<b>Art figurativ</b>	240 (8)	<b>15</b>	200	<b>15</b>	400			<b>30</b>
Drejtimi arsimor								
Pikturë								
Dizajn grafik								
Skulpturë								
Grafikë								
<b>Art muzikor</b>	240 (8)	<b>15</b>	200	<b>10</b>	400			25
<b>Drejtimi teorik-pedagogjik</b>	240 (8)							
Drejtimi pedagogjik								
Dirigjim - pauzë								
Kompozim-pauzë								
Muzikologji								
Etnomuzikologji-pauzë								
<b>Drejtimi vokal-instrumental</b>	240 (8)	<b>15</b>	200	<b>10</b>	400			25
Solo këndim								
Piano								
Violinë								
Fiz-harmonikë-pauzë								



Violë									
Violonçelo									
Kontrabas-pauzë									
Klarinet-pauzë									
Oboa-pauzë									
Kitarë-pauzë									
Flaut									
Fagot-pauzë									
Tubë-pauzë									
Korno-pauzë									
Trombë									
Instrumente me goditje									
<b>Arti dramatik</b>	240 (8)	<b>20</b>	200	<b>15</b>	400				<b>35</b>
Aktrim									
Dramaturgjii									
Regji teatri									
TV dhe regji filmi									
Kamerë									
Montazh (TV dhe montazh filmi)									
<b>FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE</b>	<b>ECTS (S)</b>	<b>40</b>	<b>200</b>	<b>30</b>	<b>400</b>	<b>30</b>	<b>400</b>		<b>100</b>
<b>Kulturë fizike dhe shëndetësi</b>	240 (8)	<b>40</b>	200	<b>30</b>	400				<b>70</b>
<b>Trajner i sportit</b>	180 (6)					<b>30</b>	400		<b>30</b>
<b>FAKULTETI JURIDIK</b>	<b>ECTS (S)</b>	<b>105</b>	<b>200</b>	<b>80</b>	<b>400</b>	<b>20</b>	<b>400</b>		<b>205</b>
<b>Studimet e drejtësisë</b>	180 (6)	<b>40</b>	200	<b>30</b>	400	<b>20</b>	400		<b>90</b>
<b>Studime në gazetari</b>	240 (8)	<b>15</b>	200	<b>10</b>	400				<b>25</b>
<b>Studime politike</b>	240 (8)	<b>15</b>	200	<b>10</b>	400				<b>25</b>
<b>Studime politike në gjuhë angleze</b>	240 (8)	<b>15</b>	200		400				<b>15</b>
<b>Kriminalistikë</b>	180 (6)	<b>20</b>	200	<b>30</b>	400				<b>50</b>
<b>FAKULTETI EKONOMIK</b>	<b>ECTS (S)</b>	<b>105</b>	<b>200</b>	<b>105</b>	<b>400</b>	<b>80</b>	<b>400</b>		<b>290</b>
<b>Financa dhe kontabilitet</b>	240 (8)	<b>25</b>	200	<b>25</b>	400	<b>20</b>	400		<b>70</b>
<b>Marketing dhe menaxhment</b>	240 (8)	<b>25</b>	200	<b>25</b>	400	<b>20</b>	400		<b>70</b>
<b>Ekonomi dhe biznes</b>	240 (8)	<b>25</b>	200	<b>25</b>	400	<b>20</b>	400		<b>70</b>
<b>Turizëm</b>	240 (8)	<b>15</b>	200	<b>15</b>	400	<b>10</b>	400		<b>40</b>
<b>Biznes ndërkombëtar</b>	240 (8)	<b>15</b>	200	<b>15</b>	400	<b>10</b>	400		<b>40</b>
<b>FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE DHE TË USHQYERIT</b>	<b>ECTS (S)</b>	<b>70</b>	<b>200</b>	<b>60</b>	<b>400</b>				<b>130</b>
<b>Teknologji ushqimore</b>	180 (6)	<b>30</b>	200	<b>20</b>	400				<b>50</b>
<b>Të ushqyerit</b>	180 (6)	<b>20</b>	200	<b>20</b>	400				<b>40</b>
<b>Menaxhimi me cilësinë dhe sigurinë e ushqimit</b>	180 (6)	<b>20</b>	200	<b>20</b>	400				<b>40</b>
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE</b>	<b>ECTS (S)</b>	<b>180</b>	<b>200</b>	<b>200</b>	<b>400</b>	<b>80</b>	<b>400</b>		<b>460</b>



<b>Mjekësi e përgjithshme</b>	360 (12)	<b>40</b>	200	<b>60</b>	50			<b>100</b>
<b>Stomatologji</b>	300 (10)	<b>25</b>	200	<b>25</b>	400			<b>50</b>
<b>Farmacii</b>	300 (10)	<b>25</b>	200	<b>25</b>	400			<b>50</b>
<b>Infermieri</b>	180 (6)	<b>50</b>	200	<b>50</b>	400	<b>40</b>	400	<b>140</b>
<b>Akusheri</b>	180 (6)	<b>20</b>	200	<b>20</b>	400	<b>20</b>	400	<b>60</b>
<b>Fizioterapi</b>	180 (6)	<b>20</b>	200	<b>20</b>	400	<b>20</b>	400	<b>60</b>
<b>FAKULTETI I ADMINISTRIM BIZNESIT- KUMANOVË</b>	ECTS (S)	<b>60</b>	<b>200</b>	<b>40</b>	<b>400</b>	<b>40</b>	<b>400</b>	<b>140</b>
<b>Administrim biznesi</b>	240 (8)	<b>30</b>	200	<b>20</b>	400	<b>20</b>	400	<b>70</b>
<b>Administratë publike</b>	240 (8)	<b>30</b>	200	<b>20</b>	400	<b>20</b>	400	<b>70</b>
<b>FAKULTETI I BUJQËSISË DHE BIOTEKNOLOGJISË</b>	ECTS (S)	<b>40</b>	<b>200</b>	<b>20</b>	<b>400</b>	<b>20</b>	<b>400</b>	<b>80</b>
<b>Prodhimtari bimore</b>	240 (8)	<b>20</b>	200	<b>10</b>	400	<b>10</b>	400	<b>40</b>
<b>Prodhimtari shtazore-pauzë</b>	240 (8)							
<b>Agrobiznes</b>	240 (8)	<b>20</b>	200	<b>10</b>	400	<b>10</b>	400	<b>40</b>
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE TË ZBATUARA</b>	ECTS (S)	<b>110</b>	<b>200</b>	<b>100</b>	<b>400</b>			<b>210</b>
<b>Ndërtimtari</b>	180 (6)	<b>25</b>	200	<b>25</b>	400			<b>50</b>
<b>Konstruktive</b>								
<b>Infrastrukturë dhe rrugë</b>								
<b>Arkitekturë</b>	240 (8)	<b>35</b>	200	<b>35</b>	400			<b>70</b>
<b>Mekatronikë</b>	180 (6)	<b>20</b>	200	<b>20</b>	400			<b>40</b>
<b>Komunikacion-Inxhinieri transporti</b>	240 (8)	<b>15</b>	200	<b>10</b>	400			<b>25</b>
<b>Gjeodezi dhe gjeoinformatikë</b>	180 (6)	<b>15</b>	200	<b>10</b>	400			<b>25</b>
<b>Inxhinieri ekonomike-pauzë</b>	180 (6)							
	<b>Gjithsej</b>	<b>1375</b>		<b>1105</b>		<b>395</b>		<b>2875</b>

## II. Kushtet dhe kriteret për regjistrim

- Të drejtë regjistrimi në studimet e ciklit të parë, kanë kandidatët që kanë dhënë maturën shtetërore ose maturën ndërkombëtare;
- Të drejtë regjistrimi në studimet e ciklit të parë, kanë kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë kryer gjatë gjendjes së jashtëzakonshme në vitin shkollor 2019/20 pa maturë shtetërore;
- Të drejtë regjistrimi në ciklin e parë të studimeve, kanë edhe kandidatët me shkollim të mesëm katërvjeçar të cilët nuk kanë dhënë maturë shtetërore, respektivisht kanë përfunduar shkollimin e mesëm katërvjeçar para vitit akademik 2007/08.  
Përrjashtim bëjnë, personat me talent të veçantë, të cilët mund t'i regjistrojnë studimet në fakultetet e drejtimit të arteve edhe nëse nuk e kanë të mbaruar shkollën e mesme katërvjeçare, me kusht që atë ta kryejnë deri në fund të vitit të dytë të studimeve, në kushtet e përcaktuara sipas Rregullores së Fakultetit.  
Nëse personi nga paragrafi i mëparshëm nuk i plotëson kushtet e theksuara, e humb statusin e studentit në fakultetin përkatës.
- Kandidatët regjistrohen si studentë të rregullt të financuar nga shteti dhe si studentë të rregullt me bashkëfinancim të studimeve.  
Në studimet e ciklit të parë, mund të regjistrohen edhe studentë me korrespondencë, nëse këtë e mundëson karakteri i programit studimor.
- Në studimet e ciklit të parë të fakulteteve mund të regjistrohen edhe kandidatë të cilët kanë të kryer arsimim të lartë apo sipëror, në fakultetet e ngjashme dhe shkollat e larta. Këta kandidatë regjistrohen jashtë kuotës, më së shumti deri në **20%** nga numri i përgjithshëm i studentëve të rregullt në fakultetin përkatës të përcaktuar në Konkurs. Kandidatët nga paragrafi i mëparshëm regjistrohen sipas suksesit nga arsimimi i mëparshëm, përveç në programet studimore për të cilat, për shkak të specifikave nevojitet verifikim i talentit. Ngjashmërinë e vërtetojnë



dhe e shpallin fakultetet. Kandidatët nga kjo pikë regjistrohen me koфинансим të studimeve, sikurse kandidatët nga kreu V i Konkursit.

6. Mënyra e seleksionimit të kandidatëve do të kryhet varësisht nga lloji i programeve studimore në të cilat konkurrojnë ata, edhe atë:
  - a) Programe studimore në të cilat seleksionimi i kandidatëve do të kryhet në bazë të suksesit nga arsimi i mesëm;
  - b) Programe studimore në të cilat seleksionimi do të kryhet në bazë të suksesit nga arsimi i mesëm dhe me kontrollim të talentit të kandidatëve. Kjo ka të bëjë me programet studimore me specifika të veçanta.
  - c) Programe studimore në të cilat mësimi mbahet në gjuhën angleze, seleksionimi do të kryhet nga sukseesi i shkollimit të mesëm dhenga rezultati i intervistimit nga komisioni përkatës.
7. Kriter bazë për seleksionimin e kandidatëve për regjistrim të studimeve deridiplomike është sukseesi i arritur në arsim të mesëm, vlerësimi i suksesit të studentëve shprehet me pikë.
  - a. Në programet studimore ku seleksionimi kryhet vetëm përmes suksesit të arsimit të mesëm, kandidatët mund të fitojnë më së shumti **100 pikë**, edhe atë: sukseesi i përgjithshëm në të gjitha lëndët merr pjesë me **60%**, ndërsa sukseesi i arritur në maturën shtetërore merr pjesë me **40%**.
    - a. 1. Në programet studimore ku seleksionimi do të kryhet vetëm në bazë të suksesit të arritur në arsimin e mesëm, llogaritja e pikëve bëhet në këtë mënyrë: mblidhen të gjitha notat, të cilat janë të evidentuara në dëftesat e notave nga të gjitha vitet, shuma e përgjithshme e fituar pjesëtohet me numrin e notave, kështu që sukseesi mesatar i fituar shumëzohet me numrin 12. Me këtë më së shumti mund të fitohen 60 pikë.
    - a. 2. Llogaritja e pikëve të suksesit të arritur nga matura shtetërore prej vitit 2013/14 bëhet në këtë mënyrë: rangimi sipas përqindjes nga provimi i lëndës eksterne, e cila jepet në maturën shtetërore shumëzohet me koeficientin 10. Në të njëjtën mënyrë llogaritet edhe përqindja e pikëve nga provimi i lëndës së dytë dhe të tretë eksterne dhe mund të fitohen maksimum 30 pikë. Rangimi sipas notës së lëndës interne (Lista 2) e përshtatshme për programin studimor, shumëzohet me koeficient 1,2, me të cilën fitohen maksimum 6 pikë, ndërsa lënda interne jo e përshtatshme me koeficient 0,6 me të cilën fitohen më së shumti 3 pikë. Nota e fituar nga detyra e projektit shumëzohet me koeficientin 0,8. Në këtë bazë mund të fitohen më shumti 4 pika. Sukseesi i përgjithshëm nga matura shtetërore më së shumti mund të sjellë 40 pikë.
    - a. 3. Llogaritja e pikëve të suksesit të arritur nga matura shtetërore deri në vitin 2012/13 bëhet në këtë mënyrë: rangimi sipas përqindjes nga provimi i lëndës eksterne, e cila jepet në maturën shtetërore shumëzohet me koeficientin 10. Në të njëjtën mënyrë llogaritet edhe përqindja e pikëve nga provimi i lëndës së dytë eksterne dhe mund të fitohen maksimum 20 pikë. Rangimi sipas notës së lëndëve interne (Lista 2) të përshtatshme për programin studimor shumëzohet me koeficient 1,6, me të cilën fitohen maksimum 16 pikë, ndërsa lënda interne jo e përshtatshme me koeficient 0,8 dhe mund të fitohen maksimum 8 pikë. Nota e fituar nga detyra e projektit shumëzohet me koeficientin 0,8. Në këtë bazë mund të fitohen 4 pikë. Sukseesi i përgjithshëm nga matura shtetërore mund të sjellë maksimalisht 40 pikë.
    - a. 4. Për kandidatët të cilët shkollën e mesme e kanë mbaruar në vitet **e mëparshme shkollore (para vitit shkollor 2007/2008) dhe kandidatët me shkollim të mesëm në vitin shkollor 2019/20** që nuk kanë mbaruar maturë shtetërore, përveç llogaritjes së pikëve nga pika 7. a. 1, llogariten edhe më së shumti 40 pikë nga lëndët të cilët janë të rëndësishme për programin studimor, edhe atë: shuma e notave nga dy lëndë të rëndësishme për programin studimor dhe dy lëndët nga lëmi i gjuhëve (gjuhë amtare dhe një gjuhë botërore) pjesëtohet me 16, dhe kështu, sukseesi mesatar i secilës lëndë veçmas shumëzohet me 8. Në këtë bazë mund të fitohen më së shumti 10 pikë për një lëndë, përkatësisht 40 pikë për katër lëndë.
    - a. 5. Vlerësimi i suksesit në programet studimore me kontrollim të talentit: mblidhen të gjitha notat që janë përfshirë në dëftesat, nga të gjitha vitet, shuma e fituar pjesëtohet me numrin e notave dhe kështu, sukseesi mesatar i fituar shumëzohet me 12. Në këtë bazë mund të fitohen më së shumti 60 pikë. Vlerësimi i suksesit nga kontrollimi i talentit bëhet me fitimin nga 0 deri në 40 pikë. Kontrollimi ka karakter eliminues me minimum 10 pikë, ndërsa në Fakultetin Pedagogjik me 20 pikë. Kontrollimi i njohurive sipas procedurës së njëjtë do të bëhet në mjekësi të përgjithshme, stomatologji dhe farmaci, për kandidatët shtetas të huaj, kandidatët me lëndë interne dhe eksterne jo të përshtatshme, kandidatët të cilët kanë kryer shkollimin e mesëm jashtë RMV-së dhe kandidatët që nuk kanë dhënë maturë shtetërore, respektivisht kanë përfunduar shkollimin e mesëm para vitit shkollor 2007/08 dhe 2019/20. Kandidatët të cilët arrijnë më pak se 40 pikë nga numri i përgjithshëm i pikëve, nuk do të pranohen.

### III. Seleksionimi i kandidatëve

1. Për përcjelljen e realizimit të Konkursit, Rektorati formon Komision Universitar të Konkursit.



2. Për llogaritjen e pikëve nga suksezi i arritur nga arsimiti i mesëm dhe nga suksezi i maturës shtetërore, Rektorati formon komisione të konkursit për secilin fakultet veçmas, ndërsa programet studimore ku bëhet kontrolli i talentit, formojnë komisione edhe për kontrollimin e talentit. Komisioni Universitar i Konkursit e përcjell realizimin e Konkursit, kujdeset për respektimin e përpiktë të dispozitave të Konkursit dhe jep udhëzime dhe mendime në procesin e realizimit të tij.

3. Rangimin e kandidatëve e kryejnë komisionet e veçanta të fakulteteve.

4. Komisioni për Konkurs, në tabelat e shpalljeve të fakultetit e shpall rangimin sipas pikëve nga suksezi i arsimit të mesëm (suksesin mesatar), pikët e lëndëve eksterne, interne dhe nga rezultatet e kontrollimit të talentit nga programet studimore në të cilat ai zbatohet (në tabelën e rezultateve do të shpallen edhe të dhënat: numri i dosjes, emri, emri i prindit dhe mbiemri, vendbanimi, shtetësia, suksezi për çdo vit shkollor, pikët e fituara nga matura shtetërore, pikët e fituara dhe statusi i pranimit)

Pas shpalljes së **listës preliminare të rangimit** të kandidatëve për regjistrim nga Komisioni për Konkurs, kandidati ka të drejtë kundërshtimi dhe ankese në afat prej 24-orësh, përmes arkivit ose përmes formës online. Në të kundërtën, e humb të drejtën për kundërshtim në procedurën e mëtejshme të ankesave për rezultatet e shpallura.

Kundërshtimi ka të bëjë vetëm me lëshimet teknike (gabime të bëra gjatë llogaritjes së pikëve), dhe i njëjti i drejtohet Komisionit universitar për pranimin e studentëve.

Aktvendimi i Komisionit është përfundimtar. Pas skadimit të afatit për parashtrimin e kundërshtimeve dhe shqyrtimit të tyre, Komisioni Universitar i Konkursit në fakultetin përkatës shpall Aktvendim për pranimin e studentëve (**lista përfundimtare e rangimit**), në bazë të së cilës bëhet regjistrimi i studentëve. Kandidatët e pranuar si dhe ata të cilët nuk janë pranuar, pas shpalljes së Aktvendimit për pranim, nuk kanë të drejtë kundërshtimi ose ankimi.

**Kandidatët të cilët në afatin kohor të paraparë për regjistrim nuk do të bëjnë regjistrim, respektivisht nuk do të dorëzojnë dokumentacionin e duhur për regjistrim në shërbimet studentore të fakultetit në të cilin janë pranuar, konsiderohet se kanë hequr dorë nga studimet dhe vendi i tyre do të shpallet si i lirë në Konkursin e radhës.**

5. Fakultetet në të cilat edhe pas përfundimit të afatit të parë të regjistrimit do të mbeten vende të paplotësuara, bëjnë regjistrim të studentëve në afatin e dytë dhe të tretë regjistruar.

6. Nëse në afatin e parë regjistruar, gjatë rangimit, në fund të listës së kandidatëve të pranuar ka më shumë kandidatë me numër të barabartë të pikëve (më së shumti pesë kandidatë), fakulteti i regjistron të gjithë kandidatët e tillë. Por, nëse numri i kandidatëve të tillë është më i madh se 5 (pesë), atëherë fakulteti, kandidatët e tillë i rangon sipas kriterëve plotësues: përshtatshmëria e projektdetyrës së punuar gjatë dhënies së provimit të maturës shtetërore, çmimet e fituara në garat republikane dhe ndërkombëtare, anëtarë të reprezentacioneve sportive të Republikës së Maqedonisë së Veriut, certifikatat e fituara për njohje të gjuhëve të huaja në nivel më të lartë etj.

7. Studentët në kuotën shtetërore regjistrohen duke paguar kompensim për bashkëfinancim të studimeve, të përcaktuar si në kreun I të Konkursit në kundërvlerë në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RMV-së. Kompensimi për studime të studentëve nga paragrafi paraprak, për secilin program studimor në veçanti, është pjesë përbërëse e këtij Konkursi. PAGESA e kompensimit kryhet në dy këste të barabarta. Kompensimin nga paragrafit 1 i kësaj pike, studentët e dorëzojnë për çdo semestër për aq sa zgjatin studimet e tyre me të gjitha detyrimet e tjera financiare të përcaktuara me Aktvendim nga ana e universitetit. .

8. Drejtoria e Rektoratit sjell Udhëzim të veçantë për realizimin e Konkursit.

#### IV. Regjistrimi i studentëve me korrespondencë

1. Në programet studimore të veçanta të fakulteteve, si studentë me korrespondencë mund të regjistrohen kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për regjistrim dhe kanë kontratë për punësim në kohë të pacaktuar, si dhe kandidatët të cilët për shkaqe të arsyeshme nuk kanë mundësi të regjistrohen si studentë të rregullt. Si shkaqe të arsyeshme nga paragrafi paraprak llogariten: të qenët person invalid, i cili nuk është në gjendje ta ndjekë mësimin e rregullt; sëmundja e rëndë kronike, e cila pamundëson vijimin e rregullt të mësimit më tepër se një semestër; prind i fëmijës deri sa zgjatë pushimi i lehonisë.

2. Studentët me korrespondencë regjistrohen sipas kushteve dhe kriterëve të njëjta si studentët e rregullt, ndërsa rangohen në lista të veçanta të rangimit.

Studentët me korrespondencë regjistrohen me koofinancim të studimeve, sipas shumës së paraqitur në tabelën nr. I.

3. Gjatë paraqitjes për regjistrim, si studentë me korrespondencë, kandidatët dorëzojnë dëshmi për punësim në kohë të pacaktuar, ose vërtetim mjekësor për shkaqet e theksuara në pikën 1, paragrafi 2.

#### V. Regjistrimi i studentëve me bashkëfinancim të studimeve

1. Në fakultete, si studentë të rregullt regjistrohen edhe kandidatë që i plotësojnë kushtet për regjistrim, ndërsa për shkak të kufizimit të kuotave nuk mund të regjistrohen në kategorinë e studentëve të financuar nga shteti.



2. Studentët që regjistrohen në këtë kategori, shumën e përcaktuar në kreun I të Konkursit e paguajnë në kundërvlerë të denarit, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RMV-së, në ditën e pagesës, në së paku në 2 këste të barabarta.

3. Fakulteti shpall listën e rangimit të kandidatëve që i plotësojnë kushtet për regjistrim në këtë kategori. Kandidatët që pajtohen të regjistrohen në këtë kategori studentësh, dorëzojnë deklaratë në afat prej 24 orëve pas shpalljes së listës përfundimtare të rangimit, se pajtohen gjatë gjithë kohës së studimeve të marrin pjesë në koofinancim të studimeve, ose nëse studenti i regjistron studimet sipas rezultateve të pranimit në koofinancim, konsiderohet se pranon të koofinancojë studimet.

Listën e kandidatëve të pranuar në këtë kategori e vërteton Komisioni i Konkursit në bazë të listës së rangimit dhe deklaratave të dorëzuara për pajtueshmëri për regjistrim në këtë kategori. Studentët me bashkëfinancim gjatë regjistrimit lidhin kontratë me fakultetin, për të drejtat dhe obligimet e ndërsjella në realizimin e procesit edukativo-arsimor.

## VI. Kandidatët me arsim të mesëm të kryer jashtë vendit

### a) Shtetasit e huaj

1. Shtetasit e huaj regjistrohen jashtë kuotave të përcaktuara në Konkurs dhe numri i tyre mund të jetë 20% nga numri i përgjithshëm i studentëve të përcaktuar me konkurs në nivel të fakultetit, përveç programeve studimore ku mësimi realizohet në gjuhën angleze.

2. Seleksionimi i shtetasve të huaj që paraqiten për regjistrim në programet studimore të mjekësisë së përgjithshme, stomatologjisë, farmacisë, kulturës fizike, artit dramatik, artit figurativ, artit muzikor, programet e Fakultetit Pedagogjik programet studimore që mbahen në gjuhën angleze dhe arkitekturë, **kryhet me anë të kontrollit të diturive dhe aftësive.**

3. Gjatë paraqitjes, kandidatët e theksojnë në cilin fakultet, respektivisht program studimor dëshirojnë të studiojnë, se a janë bursistë të qeverisë së tyre, apo vetë i bartin shpenzimet e studimeve. Me fletëparaqitje dorëzojnë diplomë për mbarimin e arsimit të mesëm, si dhe dëftesa për të gjitha klasat, përkthim të vërtetuar të certifikatës së lindjes, vërtetim për njohje të gjuhës maqedonase ose shqipe (të dhënë nga komisioni i Universitetit), dhe certifikatë për gjendjen shëndetësore (Hepatit C dhe Hiv). Shtetasit e huaj, për diplomën për mbarimin e shkollës së mesme, si dhe dëftesat për të gjitha klasat, para fillimit të vitit akademik duhet të dorëzojnë vendimin për nostrifikim nga institucioni kompetent i RMV-së, respektivisht dokumentet për fillimin e procedurës për nostrifikim.

Universiteti i Tetovës organizon kurs përgatitor për mësimin e gjuhës shqipe dhe maqedonase në Qendrën për gjuhë dhe trajnime, ndërsa kandidati kryen detyrimet e duhura për ndjekjen e kursit.

Pagesa e studimeve për shtetasit e huaj për vitin 2020/21 është 300 euro për një semestër respektivisht 600 për një vit akademik. Në programet studimore: Infermieri, Fizioterapi dhe Akushi dhe programet studimore të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara një semestër është 500 euro, respektivisht 1000 euro për një vit akademik. Në programin studimor: Mjekësi e përgjithshme, Stomatologji dhe Farmaci, pagesa e shkollimit është në shumë prej 1000 eurove për semestër, respektivisht 2000 euro për një vit akademik, nëse nuk është rregulluar ndryshe me kontratë për bashkëpunim të ndërsjellë mes universiteteve. Në këtë kategori të studentëve bëjnë pjesë edhe kandidatët, shtetas të huaj, prindërit e të cilëve apo vetë ata punojnë në përfaqësitë diplomatike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kandidatët shtetas të Republikës së Turqisë do të mund të regjistrohen vetëm sipas kriterëve të miratuara nga ana e Këshillit për arsim të lartë të Republikës së Turqisë-YOK, të cilët duhet të dorëzojnë dëshmi për dhënien e provimit pranues të organizuar nga YGS.

Shtetasit e huaj e mbajnë statusin e njëjtë deri në diplomim.

### b) Mërgimtarët dhe shtetasit e RMV-së me arsim të mesëm të kryer në tërësi dhe me arsim të mesëm të kryer pjesërisht jashtë vendit, kandidatë me maturë ndërkombëtare dhe kandidatë me shkollim të mesëm privat në RMV

1. Kandidatët, prindërit e të cilëve janë mërgimtarë dhe kandidatët shtetas të RMV-së, që **arsimin e mesëm të plotë** e kanë kryer jashtë vendit, regjistrohen jashtë kuotave, me koofinancim të studimeve.

2. Seleksionimi i kandidatëve nga pika 1, në programet studimore të mjekësisë së përgjithshme, stomatologjisë, farmacisë, kulturës fizike, artit dramatik, figurativ dhe muzikor, arkitekturës dhe të Fakultetit Pedagogjik, **kryhet me kontrollim të njohurive dhe aftësive.**

3. Kompensimi për studime i kësaj kategorie të studentëve, në varësi të programeve studimore, është përcaktuar në kreun I të Konkursit (si për kandidatët nga kreu V), respektivisht 400 euro për një vit akademik.

Kandidatët nga paragrafi i parë, mund të regjistrohen edhe sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Konkurs për kandidatët me arsim të mesëm të kryer në RMV, në kuadër të kuotës shtetërore.

Kandidatët nga pika 1, bashkë me fletëparaqitjen dorëzojnë diplomë të nostrifikuar si dhe dëftesa të nostrifikuar për katër vitet e kryera të arsimit të mesëm jashtë vendit.

4. Kandidatët shtetas të RMV-së, që një **pjesë të arsimit të mesëm** e kanë kryer jashtë vendit dhe kandidatët me maturë të mbaruar ndërkombëtare, regjistrohen me kushte dhe kriterë të njëjta, si dhe kandidatët me shkollë të



mesme të mbaruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me atë që përveç dokumenteve të tjera, dorëzojnë edhe dëftesa të nostrifikuara për pjesën e arsimit të mesëm të kryer jashtë vendit, përkatësisht me maturë të kryer ndërkombëtare.

Këta kandidatë rangohen në listë të veçantë rangimi, kurse do të pranohen ata kandidatë të cilët do të fitojnë pikë, të paktën aq sa edhe kandidati i fundit i pranuar në kuadër të kuotës shtetërore në programin studimor përkatës. Numri i këtyre kandidatëve mund të arrijë më së shumti 10%, kurse shpenzimet për studimet e tyre i bart Ministria për Arsim dhe Shkencë.

Kandidatët të cilët kanë fituar pikë, të paktën sa edhe kandidati i fundit i pranuar në kategorinë me koфинансим të studimeve, regjistrohen me kompensim për studime në lartësi të përcaktuar sipas kreut I të Konkursit. Për kandidatët të cilët regjistrohen në këtë kategori, me koфинансим të studimeve, vlejné dispozitat nga kreu V i Konkursit.

Kandidatët nga kreu VI, paraqiten në Rektoratin e UT-së, në afatet e përcaktuara me Konkurs.

5. Kandidatët të cilët kanë kryer shkollim të mesëm privat në RMV, të cilët kanë dhënë maturë shtetërore, regjistrohen sipas kushteve dhe kritereve të njëjta me kandidatët që kanë kryer shkollim sipas kreut 1 të Konkursit.

6. Kandidatët të cilët kanë kryer shkollim të mesëm privat para 2018/19, pa maturë shtetërore, regjistrohen me koфинансим të studimeve, deri në 10% nga numri i përgjithshëm i studentëve për program studimor.

#### VII. Kandidatët me të drejta të veçanta të përcaktuara sipas ligjeve të RMV-së si dhe kandidatët të cilët pranohen në kuadër të kuotës së bashkësive të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

1. Numri i studentëve, që i takojnë kategorisë së personave me të drejta të veçanta të përcaktuara me Ligjin për të drejta të veçanta të RMV-së, regjistrohen në kuotë të veçantë (pa bartje të shpenzimeve për studime), si: persona pa prind deri në moshën 26-vjeçare, nëse nuk janë të punësuar, persona me invaliditet, invalid lufte, persona të papunë të rritur në shtëpitë e fëmijëve të braktisur, ku numri i tyre mund të arrijë më së shumti 10% nga numri i përgjithshëm i studentëve në nivel të programit studimor.

2. Për sigurimin e përfaqësimit të drejtë të kandidatëve të cilët u takojnë bashkësive të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në institucionet e larta të Universitetit, në vitin akademik 2020/21, në mënyrë plotëse do të regjistrohen kandidatët të cilët u takojnë këtyre bashkësive, numri i të cilëve nuk e kalon 10 % nga numri i përgjithshëm i studentëve të cilët regjistrohen në vitin e parë në nivel të fakultetit. Në kuadër të kësaj përqindjeje, në mënyrë të drejtë do të përfaqësohen kandidatët e të gjitha bashkësive, deri në përqindjen me të cilën bashkësia përkatëse është përfaqësuar në numrin e përgjithshëm të banorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Mjetet e participimit për këta kandidatë do të mbulohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### VIII. Afatet për paraqitje, kontrollimin i njohurive dhe aftësive dhe regjistrimi

REALIZIMI I KONKURSIT PËR REGJISTRIM TË STUDENTËVE – 2020/21	AFATI I	AFATI II	Afati III
Aplikimi (dorëzimi i dokumenteve në administratë)	25-28 gusht	9-11 shtator	22-25 shtator
Kontrolli i njohurive dhe aftësive (provim pranues për programet dhe kategoritë e caktuara sipas listës 1)	29 gusht	12 shtator	26 shtator
Shpallja e rezultateve preliminare dhe afati i ankesave	31 gusht	14 shtator	28 shtator
Shpallja e vendimit për pranim të kandidatëve	1 shtator	15 shtator	29 shtator
Regjistrimi i kandidatëve	1 -5 shtator 2020	15 -18 shtator 2020	29 shtator - 2 tetor 2020

\* Për shkak të situatës së pandemisë aplikimi me dokumente, provimet pranuese në disa programe dhe regjistrimi mund të organizohen online

#### IX. Dokumentet për aplikim dhe regjistrim

1. Kandidatët e plotësojnë formularin online në ueb faqen: <http://www.unite.edu.mk/apply> (Regjistrimet 2020/21) me të dhënat përkatëse dhe sipas udhëzimeve që kërkohen;
  - A. Gjatë plotësimit të formularit, kandidatët dokumentet më poshtë duhet t'i bashkangjesin (attach) të skenuara ose si fotografi (skenimi ose fotografitë duhet të jenë të lexueshme dhe ta përfshijnë dokumentin e plotë me të gjitha të dhënat)
2. Dëftesat origjinale nga shkollimi i mesëm;
3. Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme;
4. Certifikatë nga libri amzë i të lindurve;
5. Certifikatë shtetësie;
6. Dëshmi (fletëpagesë) për pagesat e:





- a) **1050 denarëve** në xhirollogarinë e Universitetit: në emër të taksave administrative.
- b) **600 denarëve** për mjete plotësuese për secilën lëndë në të cilën kandidatët do të nënshtrohen për provim pranues, të theksuar në Listën shtesë-1, të programit studimor përkatës, ku është paraparë provimi pranues: në emër të Komisionit për verifikimin e njohurive dhe aftësive dhe intervistimit (për programet në gjuhën angleze)

Kandidatët që aplikojnë në programet ku mundësohen studime me korrespondencë, krahas dokumentacionit të caktuar më lart, duhet të dorëzojnë dokumentet përkatëse për arsyetimin e këtij statusi sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Konkurs. Kandidatët të cilët aplikojnë në bazë të kuotës së veçantë, dorëzojnë dokumentet të cilat dëshmojnë kategorinë përkatëse.

Kandidatët të cilët janë të pranuar (**pas shpalljes së listës përfundimtare**), gjatë regjistrimit duhet të dorëzojnë:  
\*Përshkak të situatës së pandemisë, procesi i regjistrimit mund të bëhet online

1. Fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjet merren në shërbimin për çështje studentore të fakultetit në të cilin studentin regjistrohet ose do të plotësohen online)
2. Tri fotografi ( dy fotografi 6 x 9 dhe një – 4 x 5 c. m.)
3. Vërtetim për pagesën e mjeteve:
  - **100 denarë** në xhirollogarinë 2401901047494695 (banka e pranuesit: Uni Banka AD Skopje): në emër të Parlamentit Studentor në Universitetin e Tetovës (SHPSUSHT)
  - **1200 denarë**, në xhirollogarinë e Universitetit: në emër të dhënies së Index-it.
  - **750 denarë**, në xhirollogarinë e Universitetit: në emër të veprimtarive informative, sportive, kulturore të studentëve të Universitetit.
  - **Pagesën e mjeteve për semestrin e parë sipas tarifave të përcaktuara në kreun I të konkursit**

Të gjitha pagesat e lartpërmendura do të kryhen në xhirollogarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:

#### Pagesa prej Maqedonisë së Veriut

- Pagesat mund të bëhen edhe përmes aplikacioneve elektronike bankare me formular **PP50** ose me fletëpagesë në bankë/postë;
- Fletëpagesa qoftë përmes aplikacionit ose fletëpagesës në bankë, duhet të figurojë në **emër të studentit**:
  - ❖ Në emri i marrësit (**назив на примачот**) - Universiteti i Tetovës,
  - ❖ Në „banka e marrësit“ (**банка на примач**) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
  - ❖ Në „llogaria“ (**сметка**) – **10000000063095**,
  - ❖ Në „shuma“ (**износ**) – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhet,
  - ❖ Në „llogaria e shfrytëzuesit buxhetor - subjekti shfrytëzues“ (**сметка на буџетски корисник – единка корисник**) – **1600160054 788 10**;
  - ❖ në „shifra dhe programi i të hyrave“ (**приходна шифра и програма**) – **723019 43**, ndërsa në „mënyra“ (начин) – **2**;
  - ❖ Në rubrikën qëllimi i realizimit të pagesës (**цел на дознака**) – qëllimi i pagesës (aplikim, semestri, indeks, provim pranues etj.).
    - o Në rast se pagesat përmes aplikacioneve bankare i kryen person tjetër për studentin e caktuar, në këtë rubrikë ((**цел на дознака**) – qëllimi i pagesës)), e shënon edhe emrin e studentit për të cilin e kryen pagesën (shembull: aplikim:Emri dhe Mbiemri)

#### Pagesa prej jashtë shtetit

**NATIONAL BANK OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA**  
**Emri: Drzaven univerzitet vo Tetovo**  
**IBAN: MK07 1007 0100 0066 227**  
**SWIFT BIC: NBRM MK 2X**

Konkursi është shpallur në faqen e internetit: <http://www.unite.edu.mk>

**Lista 1. Programet studimore në të cilat përveç zgjedhjes së lëndëve interne adekuate të dhëna në listën nr. 2, për shkak të specifikave të studimit kryhet kontrollimi i talentit dhe njohurive**

Programet studimore në të cilat regjistrimi bëhet **me provim pranues**:

- a) Mjekësi e përgjithshme
- b) Stomatologji



- c) Farmaci
- e) Art figurativ
- f) Art muzikor
- g) Art dramatik
- h) Kulturë fizike: Aktivitet fizik, rekreacion dhe shëndetësi; sport
- i) Informatika në gjuhën angleze
- j) Studime politike në gjuhën angleze
- l) Mësim klasor
- ll) Drejtim parashkollor
- m) Arkitekturë

### 1. Kontrollimi i njohurive për të gjithë kandidatët:

#### 1.1 Fakulteti i Arteve

- **Kontrollimi i talentit në programin studimor: Art figurativ do të mbahet në:**

- a. Vizatim – portret i modelit të gjallë

- **Kontrollimi i talentit në programin studimor: Art muzikor do të mbahet në:**

- a) Solfezh b) Piano obligat c) Harmoni

- **Kontrollimi i talentit në programin studimor: Art dramatik do të mbahet në:**

- A. Ndjenjë e ritmit dhe dëgjimit,

B. Interpretimi i një monologu dramatik dhe i një kënge nga zgjedhja e kandidatit dhe një nga zgjedhja e komisionit,

- C. Improvizimi i temës së dhënë;

- Drejtimi: **Regjia e filmit dhe TV**

- A. Ese (punim me shkrim) në temën e dhënë (analiza e një filmi artistik) dhe bisedë me kandidatët;

-Drejtimi: **Montazh**

- A. Kontrollim i talentit muzikor

- B. Provimi me shkrim - analizë e montazhit të filmit të treguar në një film artistik

-Drejtimi: **Kamerë**

A. Prezantim i koleksionit personal të fotografive (10 fotografi bardhë e zi, të përpunuara në laboratorin fotografik në konvencionin jodijital me teknikë fotografike dhe format më të vogël 18 x 24 cm)

B. Informimi, motivimi si dhe përcaktimi i njohurive dhe shkathtësive të kandidatëve për studime në artin dramatik, do të përcaktohet përmes bisedës me kandidatët.

Provimet në të gjitha programet, respektivisht drejtimet e Fakultetit të Arteve do të mbahen në hapësirat përkatëse të programeve më: **29 gusht 2020 (e shtunë), ora: 10<sup>00</sup>**. (për informata më të hollësishme vizitoni faqen zyrtare të Universitetit)

#### 1.2. Fakulteti i Kulturës Fizike - Provimi pranues në programin studimor: kulturë fizike, aktivitet fizik, rekreacion dhe shëndetësi; sport do të mbahet nga:

- A. Not

- B. Hendboll, basketboll, volejball, gjimnastika sportive

- C. Atletikë

Provimi pranues do të mbahet më: **29 gusht 2020 (e shtunë) ora: 09<sup>00</sup>** në hapësirat e Fakultetit të Kulturës Fizike. Kandidatët me vete duhet të marrin përgatitje sportive dhe dokument identifikimi.

#### 1.3 Intervista në programet studimore ku mësimi do të mbahet në gjuhën angleze:

Intervista për njohuritë dhe aftësitë në gjuhën angleze para komisionit përkatës do të mbahet më: **29 gusht 2020 (e shtunë) ora: 10<sup>00</sup>**, në hapësirat e Universitetit afër Rektoratit.

#### 1.5 Fakulteti Pedagogjik: mësim klasor dhe drejtimi parashkollor

**Provimi do të mbahet më 29 gusht 2020 (e shtunë), në këto fusha:**

- Testim i aftësive intelektuale, test i inteligjencës joverbale dhe intervistë e strukturuar për aftësitë e komunikimit, ora: **09<sup>30</sup>**
- Testimi i lëvizjeve motorike, ora: **13<sup>00</sup>**: kandidatët duhet të kenë përgatitje sportive

#### 1.6 Fakulteti i Shkencave të Zbatuara - provimi pranues në arkitekturë do të mbahet nga:

- A. Vizatim – kreacion i lirë i objekteve

- Provimi pranues do të mbahet më: **29 gusht 2020 (e shtunë), ora: 10<sup>00</sup>** në hapësirat e Arkitekturës.

- 2. **Programet studimore, lloji dhe përmbajtja e testimit/seleksionimit (përmes kontrollit të njohurive dhe aftësive) për kandidatët të cilët kanë kryer shkollim të mesëm dhe nuk kanë dhënë maturë shtetërore**



(2007/08 dhe 2019/20), shtetas të RMV-së me shkollim jashtë shtetit, kandidatë me lëndë interne dhe eksterne jo të përshtatshme dhe kandidatë shtetas të huaj:

**2.1 Provimi pranues në programet studimore: mjekësi e përgjithshme, stomatologji dhe farmaci:**

A. Biologji (njohuri të fituara nga arsimi i mesëm)

B. Kimi (njohuri të fituara nga arsimi i mesëm)

*Kandidatët të cilët nga lëndët A dhe B, kanë dhënë së paku njërën në lëndë eksterne ose interne, provimit pranues do t'i nënshtrohen vetëm në njërën nga lëndët. Për kandidatët të cilët lëndët e përmendura i kanë në pjesën interne, Komisioni qendror do të sjellë vendim për pjesëmarrje në provim pranues.*

Provimi pranues do të mbahet më: **29 gusht 2020 (e shtunë), ora: 11<sup>00</sup>**, në hapësirat e Universitetit te objekti i ri (Rektorati). Kandidatët duhet të kenë me vete dokument identifikimi.

Në rast se provimet pranuese do të mbahen online për shkak të situatës së pandemisë, universiteti do të shpall procedurën përkatëse për kyçe, në ueb faqen e universitetit [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk)

**Lista 2. Lëndët interne dhe eksterne të përshtatshme për regjistrim**

Fakulteti	Lëndë eksterne dhe interne të përshtatshme	
<b>Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore</b>	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Informatikë, matematikë, biologji, kimi ose një lëndë nga fusha e shkencave natyrore, varësisht lëndëve eksterne Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar
<b>Fakulteti Filozofik</b>	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Informatikë, matematikë, biologji, sociologji, histori, gjuhë e huaj, filozofi, estetikë, varësisht lëndëve eksterne Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar
<b>Fakulteti Pedagogjik</b>	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Pa kufizim
<b>Fakulteti Filologjik</b>	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Gjuhë e huaj, informatikë, matematikë, sociologji, filozofi, varësisht lëndëve eksterne Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar
<b>Fakulteti Ekonomik</b>	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Gjuhë e huaj, informatikë, matematikë, biznes, varësisht lëndëve eksterne Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar
<b>Fakulteti Juridik</b>	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Gjuhë e huaj, matematikë, histori, filozofi, estetikë, sociologji, biznes, filozofi varësisht lëndëve eksterne Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar
<b>Fakulteti i Arteve</b> <b>Fakulteti i Kulturës fizike</b>	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Pa kufizim
<b>Fakulteti i Shkencave Mjekësore</b>	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	<i>Mjekësi e përgjithshme, stomatologji, farmaci:</i> kimi, biologji, Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e shëndetësisë <i>Infermieri, akusherë, fizioterapi:</i> Informatikë, biologji, kimi, gjuhë e huaj, varësisht lëndëve eksterne Lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale nga profili i arsimimit
<b>Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit</b>	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Informatikë, biologji, matematikë, gjuhë e huaj, kimi, fizikë, varësisht lëndëve eksterne Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar
<b>Fakulteti i Administrimit të Biznesit - Kumanovë</b>	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Gjuhë e huaj, matematikë, informatikë, filozofi, biznes, sociologji, varësisht lëndëve eksterne Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar
<b>Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë</b>	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Informatikë, matematikë, biologji, kimi ose një lëndë nga fusha e shkencave natyrore, gjuhë e huaj, fizikë varësisht lëndëve eksterne Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar
<b>Fakulteti i Shkencave të Zbatuara</b>	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	<i>Arkitekturë:</i> pa kufizim <i>Programet tjera studimore:</i> Informatikë, matematikë, kimi, fizikë, estetikë, gjuhë e huaj, varësisht lëndëve eksterne Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale

Për të gjitha fakultetet dhe programet studimore, lëndën e dytë interne, respektivisht lëndën interne, maturanti e zgjedh nga lista e lëndëve profesionale në varshmëri prej profilin të përgatitjes arsimore të kandidatit.